

Asambleja e 11-te e Federates Europiane te Sportit Universitar



Ne date 4-6 Dhjetor u zhvillua ne Vjene (Austri) Asambleja e 11-te e Federates Europiane te Sportit Universitar. Ne te, perfaqesuan sportin universitar shqiptar Prof. Mehmet Spahiu dhe Prof,Asc. Fatos Gjata. Punimet e kesaj asambleje perkonin me 10 vjetorin e krijimit te kesaj federate. (Sporti universitar shqiptar eshte anetar me te drejta te plota i kesaj federate qe ne vitin 2005).

Eshte hera e dyte qe Akademia e Sportit mbeshtet pjesemarrjen ne keto veprimtari te sportit universitar shqiptar.

Ne kete Asamble u be bilanci i punes se deritanishme dhe u vendosen piketat e punes per te ardhmen. Me interes ishin takimet me kreret me te larte drejtues te kesaj federate, te cilet vleresuan punen e deritanishme te sportit universitar shqiptar dhe premtuan mbeshtetjen e tij nga keto struktura ne te ardhmen duke qene se shpejti pjesemarres aktive ne ndihme te ecurise se sportit universitar shqiptar perkrah vendeve te tjera te balkanit e me gjere.

Me interes ishte dhe konferenca e mbajtur me kete rast, ku u vleresua pjesemarrja e Rektorit te Universitetit te Vjenes Prof.Georg Winckler qe eshte njekoheisht dhe President nderi i kesaj federate si dhe kumtesa e mbajtur nga Profesori i Sociologjise se Sportit ne kete universitet. Prof. Otmar Weiss. Ne kete kuader, per te ecur me te njejtin hap me vendet e tjera te



rajonit eshte e rendesishme krijimi i strukturave te nevojshme te sportit universitar ne vend; ngritja e infrastruktures sportive (krijimi i qendrave universitare sportive prane universiteteve te vendit); organizmi i veprimtarive sportive universitare ne shkalle vendi si dhe pjesemarrja ne veprimtarite sportive studentore nderkombetare.



Anetar i delegacionit shqiptar

Prof.Asc Dr. Fatos Gjata